



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prefekti Qarkut Fier

Nr. 682 Prot.

Datë, më 13/06/2025



MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORE

Nr. 1748..... Prot.

Vlorë, më 13/06/2025

Lënda : Kërkesë për Shpallje Publike të aktit administrativ (Vendimi i kontabilizimit)

PREFEKTIT TË QARKUT - FIER

Duke vlerësuar me kënaqësi bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet institucioneve tona, në bashkërendimin e veprimeve për zgjidhjen e problemeve të dyanëshme, si dhe me synimin e përmbushjes së misioneve tona të ngarkuara nga Ligji, e shohira të domosdoshëm forcimin e mëtejshëm të këtij bashkëpunimi, pasi nga ana jonë konstatohet se në shumë raste nëpërmjet Tij, është mundur shlyerja e borxhit doganor.

Në respektim të Ligjit Nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 48/4 i Tij “Bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve” - “Institucionet publike dhe strukturat e Policisë së Shtetit ndihmojnë autoritetet doganore sa herë që këto të fundit kërkojnë ndihmën e tyre për zbatimin e legjislacionit doganor, në përputhje me funksionet dhe kompetencat e tyre”, në zbatim të Ligjit Nr.8116, datë 29.03.1996 “Kodi i Procedurës Civile”, neni 131 i Tij “Kur nuk është i mundur njoftimi sipas dispozitave të mësipërme, njoftimi bëhet në vendbanimin apo vendqëndrimin e marrësit ose në zyrën apo vendin ku ushtron veprimtarinë tregtare, industriale...”, nenit 162/2 të Ligjit Nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” - “Njoftimi publik bëhet nëpërmjet shpalljes së shkresës në një kënd të posaçëm për njoftimet në selinë e organit dhe në degët ose në zyrat e tij vendore, në prefekturën apo në një vend tjetër dhe ku mendohet se mund të merret dijeni nga ai/ajo, të cilit i drejtohet”, si dhe në zbatim të Udhëzimit Nr. 15, datë 03.12.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave Tiranë, “Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të akcizës”, pika VI.3.b e Tij, “Kur nuk gjendet adresa apo nuk dihet vendndodhja e subjektit debitor, apo ky i fundit nuk gjendet me adresën e kërkuar,

njoftimi mund të bëhet edhe përmes lajmërimit publik. Këto njoftime do të vihen në stendën e krijuar posaçërisht për njoftim....si dhe në vende publike si në Bashki, Njësi Administrative, në gazetën e pushtetit vendor, në internet dhe me mjete të tjera audiovizive etj. Në këto raste pas kalimit të një periudhe 30 ditore, subjekti debitor konsiderohet i njoftuar”, kërkojmë nga ana Juaj :

♦ **“Shpalljen Publike”** për një periudhë kohore jo më pak se 30 (Tridhjetë) ditë të një akti administrativ – Vendimi i kontabilizimit të detyrimeve doganore si vijon :

- Nr.55, me Nr.1199/2 Prot., datë 13/05/2025, i materializuar për subjektin “ALBA CONVERTING” sh.p.k me NUIS L77313203E, me seli në Fier (Drizë, Faqe 155, ZK 1557, Zona Industriale (Ex Azotikut).

Bashkëngjitur, gjeni kopje të aktit të lartcitur - gjithsej 2 (dy) fletë.

Jemi në pritje të *konfirmimit* nga ana Juaj për datën e shpalljes publike të aktit të lartcitur.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin,

KRYETARI
Artan Bedinaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANËS VLORË

Nr. 1199/2 Prot.

Vlorë, më 13/05/2025

VENDIM Nr.55

Sot, më datë 13/05/2025, unë Kryetari i Degës së Doganës Vlorë, pas marrjes në shqyrtim të Proces - Verbalit të verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032737, nr.1199 Prot., datë 18/04/2025, i mbajtur nga ana e Grupit i Kontrollit – Zyrës së Mbikqyrjes Doganore në ngarkim të subjektit “ALBA CONVERTING” sh.p.k me NUIS L77313203E, me seli në Fier (Drizë, Faqe 155, ZK 1557, Zona Industriale (Ex Azotikut), me administrator znj. Elisabeta Yzeiraj,

K O N S T A T O V A S E :

Nga kontrolli dhe verifikimi i kryer, rezulton se subjekti “ALBA CONVERTING” sh.p.k me NUIS L77313203E, vepron nën Autorizimin e Regjimit të Përpunimit Aktiv Nr 20452/1 datë 12.05.2023, i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për prodhimin e pecetave për pastrim, artikujve higjenik dhe të kujdesit individual, letrave të lagura, veshje pëlhurë, mbulesa shtrati dhe fasho.

Sistemi i autorizuar: me pezullim; Sasia e vlerësuar: 2.249.000 kg; Vlera e vlerësuar: 4.348.600 euro;

Periudha e vlefshmërisë : 12 muaj; Kufiri kohor për rieksporim: 360 ditë.

Në fund të periudhës , situata e autorizimit sipas sistemit ORACLE paraqitet si më poshtë:

Procedura doganore	Pesha	Vlera e materialeve
Import (5100)	52.418 kg	21.791,5 euro
Transferim nga Aut Nr 22562/1 datë 26.02.2021	305.540,77 kg	161.968,06 euro
Eksport (3151)	37.265 kg	23.582,97 euro
Gjendja në datën 28.02.2025	320.693,77 kg	160.176,59 euro

Importi i fundit nga ana e subjektit është kryer në datën 08.08.2023, procedura e transferimit të mallrave nga autorizimi nr.22562/1, dt. 26.02.2021 në autorizimin Nr.20452/1, datë 12.05.2023, është kryer në datën 19.05.2023 dhe riekporti i fundit është kryer në datën 02.11.2023.

Bazuar në Udhëzimin Nr.4 datë 28.03.2019, kreu II, pika 12 *“Afati i rieksportimit apo vendosjes në një regjim tjetër doganor është periudha që duhet për përpunimin e mallrave dhe ri - eksportimin apo vendosjen e tyre nën një regjim tjetër doganor të produkteve të përpunuara. Ky afat llogaritet nga data e hyrjes së mallrave në territorin shqiptar”*.

Në autorizimin e regjimit të përpunimit aktiv Nr 20452/1, datë 12.05.2023, pika 12, afati i rieksportimit është 12 muaj. Pra afati i rieksportimit apo vendosjes nën një regjim doganor të produkteve të importuara ka përfunduar në datën 08.08.2024. Pra subjekti nuk i ka dhënë destinacion doganor mallrave të vendosura në regjimin e përpunimit aktiv Nr.20452/1, datë 12.05.2023, brenda afatit të përcaktuar në autorizim.

Sasia (kg)	Vlera euro	Kursi mesatar	Baza
320.693,77 kg	160.176,59 euro	108	17.299.071,72 lekë
Detyrimi TVSH 20 %			3.459.814,34 lekë

Detyrimi doganor (lekë)	Penaliteti (2 fish i detyrimit doganor)	Totali (lekë)
3.459.814,34 lekë	6.919.628,68 lekë	10.379.443 lekë

Nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë, është vlerësuar se për diferencën prej 320,693.77 kg me vlerë 160,176.59 euro nga ana e subjektit është konsumuar kundërvajtja administrative e parashikuar në Nenin 250 pika 1/ a dhe Nenin 252 pika “c” të Kodit Doganor dhe duhet të penalizohet në mbështetje të Nenit 257, pika 1/ a dhe pika 2 e Kodit Doganor.

Në përfundim të kontrollit të ushtruar, nga ana e Zyrës së Mbikqyrjes Doganore pranë Degës së Doganës Vlorë, është mbajtur Proces – Verballi i verifikimit të kundërvajtjes administrative me numër serial 0032737, nr.1199 Prot., datë 18/04/2025, ku në pjesën përshkruese është parashtruar si vijon : *“Subjekti “Alba Converting” me Nipt L77313203E, i pajisur me autorizimin e R.P.A Nr.20452/1 dt 12.05.2023, nuk i ka dhënë destinacion doganor mallrave brenda afateve të përcaktuara në autorizim. Sasia e mallrave pa destinacion doganor është 320693,77 kg me vlerë 160,176,59 Euro”*.

Rezulton se subjekti ka marrë dijeni për proces verbalin e lartcitur dhe nuk ka administruar në sekretarinë e Degës së Doganës Vlorë kundërshtim/observacion ndaj tij.

Referuar nenit 250, pika 2, të Ligjit nr.102/2014, datë 31.07.2014 *“Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”* (i ndryshuar), në të përcaktohet qartë që : *“Kundërvajtje administrative është shkelja me faj e dispozitave ligjore ose nënligjore në fushën doganore, të kryera me veprim ose mosveprim dhe për të cilat ky Kod parashikon dënim administrativ”*.

Neni 252 shkronja “c” parashikon si vijon : *Pa cënuar dispozitat për kontrabandën, veprimet ose*

mosrespektimi nga

personi ndaj të cilit është dhënë vendimi, në lidhje me zbatimin e legjislacionit doganor, i detyrimeve që rrjedhin nga ky vendim, në përputhje me pikën 1, të nenit 28;

Ndërsa në nenin 257, 1/a kemi : 1. Sanksionet e vendosura për kundërvajtjet e përmendura në nenin 252 duhet të jenë efektive, proporcionale e dekurajuese dhe vendosen brenda kufijve të mëposhtëm: a) kur kundërvajtja ka të bëjë me mallrat (ndryshime në sasi, vlerë, origjinë, lloj) dhe sjell diferenca në pagesën e detyrimeve që duhen paguar për mallrat, zbatohet sanksion në masën 2-fish të detyrimit të munguar;

Për sa më lart, mbështetur në Ligjin nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), V.K.M nr.651 datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të Kodit Doganor”, Udhëzimin Nr.4 datë 28.03.2019 “Për zbatimin praktik të regjimit të përpunimit aktiv”.

V E N D O S A :

- Subjekti “ALBA CONVERTING” sh.p.k me NUIS L77313203E, me seli në Fier, detyrohet të paguajë detyrimin doganor në shumën **3,459,815** (Tremilion e katërqind e pesëdhjet e nëntë mijë e tetëqind e pesëmbëdhjetë) lekë.
- Subjekti “ALBA CONVERTING” sh.p.k me NUIS L77313203E, me seli në Fier, të penalizohet në masën e dyfishit të detyrimit doganor të papaguar në shumën **6,919,630** (Gjashtëmilion e nëntëqind e nëntëmbëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë) lekë, bazuar në nenin 257/1/a të Kodit Doganor.
- Zyra e Financës, Borxhit Doganor këtu, të kryejnë menjëherë kontabilizimin e detyrimeve përkatëse dhe të zbatojnë procedurat ligjore në fuqi, me qëllim rikuperimin e detyrimeve doganore.
- Zyra e Mbikëqyrjes Doganore të procedojë me mundësimin dhe vendosjen e mallrave në regjimin doganor përkatës, në përputhje me përcaktimet e legjislacionit doganor në fuqi
- Kundër këtij vendimi, subjekti “ALBA CONVERTING” sh.p.k me NUIS L77313203E, i lejohet të ushtrojë ankim administrativ të arsyetuar brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi, pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave - Tiranë, duke parapaguar 100 % detyrimin doganor, si dhe duke garantuar 100% penalitetin doganor, në zbatim të nenit 282 të Ligjit nr.102/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

KRYETAR

Artan Bedinaj

